**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria-Vlada-Government*
**Ministria e Ekonomisë**
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**

---

# RAPORTI I PROGRESIT PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2025

# I

# PROGRAMIT TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË ENERGJISË SË KOSOVËS (PZSEK) PËR PERIUDHËN 2022 - 2025

**Prishtinë, gusht 2025**

# Përmbajtja

**1.** SHKURTESAT ..........3
**2.** INFORMATA TË PËRGJITHSHME ..........4
**2.1.** PROGRESI I PËRGJITHSHËM..........5
**2.2.** PROBLEMET DHE RREZIQET..........6
**2.3.** SFIDAT DHE MANGËSITË ..........7
**2.4.** KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET PËR HAPAT E ARDHSHËM..........7
**2.5.** HAPAT E ARDHSHËM ..........8
**3.** INFORMACIONE TË DETAJUARA PËR ZBATIMIN E AKTIVITETEVE ..........8
**4.** SHTOJCA - MATRICA E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025..........11

# 1 Shkurtesat:

| | |
|---|---|
| BE | Bashkimi Evropian |
| BRE | Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë |
| BRE-E | Energjia elektrike e prodhuar nga Burimet e Ripërtëritshme |
| CERT | Ekipi i komunitetit për reagim urgjent |
| $CO_2$ | Dioksidi i Karbonit |
| EE | Efiçienca e Energjisë |
| ESCO | Kompania e Shërbimit të Energjisë |
| VNMS | Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social |
| PZSE | Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë |
| FKEE | Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë |
| GS | Gazrat Serrë |
| IPF9 | Objekti i Projektit të Infrastrukturës - Asistencë Teknike 9 |
| KEDS | Kompania Kosovare e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike |
| KEK | Korporata Energjetike e Kosovës |
| KfW | Instituti i Kredive për Rindërtim |
| KOSTT | Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës |
| Ktoe | Kilo ton ekuivalent naftë |
| MAShT | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit |
| MCAK | Llogaria e Sfidës së Mijëvjeçarit-Kosovë |
| MCC | Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit |
| ME | Ministria e Ekonomisë |
| MFK | Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë |
| MFPT | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| MMPHI | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| MW | Mega Vat |
| MWt | Mega Vat termik |
| NOx | Oksidet e Azotit |
| NQ | Ngrohja Qendrore |
| OSSh | Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes |
| OST | Operatorët e Sistemit të Transmetimit |
| SAIDI | Indeksi Mesatar i Kohëzgjatjes së Ndërprerjes së Sistemit |
| SAIFI | Indeksi i Frekuencës Mesatare të Ndërprerjeve të Sistemit |
| SCADA | Kontrolli Mbikëqyrës dhe Marrja e të Dhënave |
| $SO_2$ | Dioksidi i Sulfurit |
| ETS BE | Sistemi i Tregtimit të Emetimeve të Bashkimit Evropian |
| WBIF | Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor |
| ZRrE | Zyra e Rregullatorit për Energji |

## 2. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Ministria e Ekonomisë (ME), ka hartuar Programin e Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK), për periudhën 2022-2025, i cili është miratuar më 5 shtator të vitit 2023 nga Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK).

Bazuar në nenin 7, pika 7 e Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, Ministria e Ekonomisë (ME), ka obligim ligjor që të bëjë monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës. Prandaj Ministria ka hartuar raportin gjashtë (6) mujor janar-qershor 2025, mbi progresin e realizimit të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025, si dhe nivelin e zbatimit të Strategjisë së Energjisë për periudhën 2022-2031, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Manualin për planifikimin, hartimin, dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit.

Raporti i Progresit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë për periudhën janar-qershor 2025 është hartuar, bazuar në realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në Programin e Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025.

Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025, përfshin një listë prej pesë (5) objektivash strategjike, pesëmbëdhjetë (15) objektivash specifike dhe nëntëdhjetë (90) aktiviteteve që parashihen të realizohen për zhvillimin e sektorit të energjisë.

Raporti i progresit ka për qëllim që të evidentoj shkallën e realizimit të projekteve/aktiviteteve të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën janar-qershor 2025, si dhe të evidentohen sfidat dhe të propozohen rekomandimet për vendimmarrje nga autoritetet përkatëse.

**Objektivat strategjike janë:**

Objektivi 1: Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit;
Objektivi 2: Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme;
Objektivi 3: Rritja e Efiçiencës së Energjisë (EE);
Objektivi 4: Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut;
Objektivi 5: Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve.

## 2.1. PROGRESI I PËRGJITHSHËM

Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën 2022-2025 për vitin 2025 janë paraparë të përfundohen gjithsej tridhjetë (30) aktivitete, por janë edhe njëzet e gjashtë (26) aktivitete të tjera të cilat janë bartur nga viti 2023 dhe viti 2024. Nga viti 2023 janë bartur gjithsej njëmbëdhjetë (11) aktivitete ndërsa nga viti 2024 janë bartur pesëmbëdhjetë (15) aktivitete. Nga gjithsej pesëdhjetë e gjashtë (56) aktivitete në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2025 vetëm në dyzet (40) prej tyre ka pasur progres, ndërsa në gjashtëmbëdhjetë (16) aktivitete nuk ka pasur progres.

Objektivi një (1) i PZSEK-së është realizuar tridhjetë e nëntë përqind (39%) në periudhën janar-qershor 2025, objektivi dy (2) tridhjetë e tetë për qind (38%), objektivi tre (3) dyzet e nëntë për qind (49%), objektivi katër (4) njëzet e një për qind (21%) dhe objektivi pesë (5) është realizuar tetëdhjetë për qind (80%).

Në vazhdim janë paraqitur arritjet e realizimit të objektivave në formë tabelare dhe grafike:

**Tabela 1.** Përqindja e realizimit të objektivave janar - qershor 2025

| | **janar - qershor 2025** |
|---|---|
| Objektivi 1 | 39% |
| Objektivi 2 | 38% |
| Objektivi 3 | 49% |
| Objektivi 4 | 21% |
| Objektivi 5 | 80% |
| **Totali i zbatimit të objektivave** | **45%** |

**Figura 1.** Përqindja e realizimit të objektivave janar - qershor 2025



Totali i realizimit të objektivave për periudhën janar- qershor 2025 është dyzet e pesë për qind (45%).

Për periudhën janar - qershor 2025, vetëm tri (3) aktivitete apo pesë pikë tridhjetë e gjashtë për qind (5.36%) janë realizuar plotësisht, pjesërisht janë realizuar gjithsej tridhjetë e shtatë (37) aktivitete apo gjashtëdhjetë e gjashtë pikë zero shtatë për qind (66.07%), ndërsa aktivitete të cilat nuk janë realizuar janë gjashtëmbëdhjetë (16) apo njëzet e tetë pikë pesëdhjetë e shtatë për qind (28.57%).

Në vazhdim të dhënat e mësipërme janë të paraqitura edhe në formë grafike:

**Figura 2.** Përqindja e realizimit të aktiviteteve për periudhën janar - qershor 2025




Objektivi me realizueshmërinë më të mirë për periudhën janar- qershor 2025 është objektivi i pestë (5), respektivisht - mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve, ndërsa objektivi i cili ka pasur realizueshmërinë më të ulët për këtë periudhë është objektivi i katërt (4), respektivisht - forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut.

## 2.2. PROBLEMET DHE RREZIQET

Ky monitorim është bërë duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse ku janë identifikuar rreziqet të cilat do të adresohen në vitet e ardhshme me masa konkrete. Ministria e Ekonomisë (ME), do të vazhdoj bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet relevante dhe ndërmarrjet kryesore të sektorit të energjisë në adresimin e të gjitha rreziqeve me të cilat vazhdojnë të ballafaqohen.

Gjatë monitorimit të zbatimit të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (PZSEK) për periudhën janar-qershor 2025, janë hasur disa rreziqe të cilat ndërlidhen me

kapacitetin institucional, kapacitetin financiar, mjedisin rregullator, partneritetin dhe angazhimin e institucioneve të tjera, si dhe faktorë të tjerë të jashtëm që janë shfaqur gjatë realizimit të aktiviteteve, dhe që ndikojnë në zbatimin e dokumentit strategjik.

Konstatimi i ngecjeve në realizimin e disa projekteve të parapara na drejton në marrjen e hapave të domosdoshëm dhe konkret në eliminimin e barrierave që pengojnë zhvillimin e sektorit të energjisë. Planifikimi i projekteve dhe aktiviteteve nga institucionet përgjegjëse për energji elektrike, është mjaft i rëndësishëm në suksesin dhe zhvillimin e sektorit të energjisë. Një rol të rëndësishëm luan edhe lehtësimi i procedurave te shumta me qëllim të mos vonesës dhe ngecjes së projekteve.

## 2.3. SFIDAT DHE MANGËSITË

Sfidat, mangësitë dhe pengesat e hasura gjatë monitorimit të këtij dokumenti janë të njëta me ato të cilat janë paraqitur edhe në monitorimin e zbatimit për vitet 2023-2024.

Gjatë realizimit të projekteve dhe aktiviteteve të parapara, institucionet përgjegjëse kanë sfida, mangësi dhe pengesa varësisht nga natyra e projekteve. Si sfida të paraqitura janë: vonesa në marrjen e lejeve nga institucionet përkatëse për ndërtim, vonesa në procese të prokurimit, zbatimi i projekteve në afërsi të lokacioneve të projektit që janë paraparë për zhvillim, mospërdorimi i pajisjeve inteligjente të pajisura me mbrojtje kibernetike brenda infrastrukturës ekzistuese të rrjetit të shpërndarjes, qasja në banesa të konsumatorëve mungesa e ekspertëve, si dhe proceset të tjera të karakterit vendore dhe ndërkombëtare, të cilat potencialisht kanë ndikuar në vonesa në realizimin e aktiviteteve.

## 2.4. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET PËR HAPAT E ARDHSHËM

Gjatë monitorimit të Raportit të Progresit për periudhën janar–qershor 2025, është evidentuar se realizimi i aktiviteteve ka arritur në dyzet e pesë për qind (45 %).

Disa nga faktorët që kanë ndikuar në ngadalësimin e zbatimit përfshijnë: mosratifikimin e marrëveshjeve financiare në Parlamentin e Republikës së Kosovës (PRK), planifikimin jo të përshtatshëm të afateve kohore për implementimin e aktiviteteve, si dhe varësinë e disa prej tyre nga dokumente strategjike dhe programe që është dashur të miratohen dhe të hyjnë në fuqi paraprakisht.

Përveç këtyre, si faktorë pengues janë identifikuar procedurat e shumta për marrjen e lejeve të ndryshme dhe proceset e prokurimit. Gjithashtu, është vërejtur mungesë e fuqisë punëtore me profile të specializuara, e cila ka ndikuar në dinamikën e zbatimit.

## 2.5. HAPAT E ARDHSHËM

Hapat e ardhshëm, të bazuara në konkluzionet dhe gjetjet nga raportimi i institucioneve mbi zbatimin e aktiviteteve dhe masave në kuadër të objektivave strategjike, përfshijnë:

- Përmirësimin e planifikimit të afateve kohore për miratimin e kornizës ligjore;
- Planifikim më të saktë të aktiviteteve dhe përcaktimin e afateve të realizimit të projekteve nga institucionet, duke marrë parasysh pengesat dhe sfidat e mundshme gjatë zbatimit;
- Nënshkrimin dhe ratifikimin në kohë të marrëveshjeve financiare nga institucionet përgjegjëse;
- Përfshirjen aktive të palëve të interesit me qëllim përshpejtimin e proceseve.

# 2 INFORMACIONE TË DETAJUARA PËR ZBATIMIN E AKTIVITETEVE

**Objektivi 1: Përmirësimi i Besueshmërisë së Sistemit**

Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit, përfshin të gjitha aktivitetet që garantojnë sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe funksionimin e një sistemi elektroenergjetik stabil.

Aktivitetet e parapara dhe të cilat kanë pasur zhvillime në këtë periudhë, që kanë ndikuar në përmirësimin e besueshmërisë së sistemit, janë:

- Investimet kapitale në Teknologjinë Informative (TI) ku janë bërë përparime të rëndësishme në zhvillimin dhe përmirësimin e sistemeve të IT-së;
- Projektet e tensionit të Mesëm 35/10 (20) kV është arritur një progres i konsiderueshëm në realizimin e implementimit të projekteve investive në rrjetin e tensionit të mesëm pothuajse në të gjithë territorin e vendit, me fokus të veçantë në rajonet: Prishtinë, Drenas, Fushë-Kosovë, Podujevë, Gjakovë, Malishevë, Rahovec, Pejë, Deçan , Ferizaj, Prizren, Suharekë, Viti, Vushtrri.
- Projektet e tensionit të Lartë 110/10 (20) kV ku është përfunduar ndërtimi i nënstacionit Ferizaj 3, si dhe janë marrë kushtet ndërtimore, ndërsa për nënstacionin Malisheva është në pritje të lejes ndërtimore.

**Objektivi 2: Dekarbonizimi dhe Promovimi i Energjisë së Ripërtëritshme**

Në periudhën janar – qershor 2025 është shënuar progres në hartimin dhe draftimin e disa dokumenteve, si dhe në zhvillimin e disa projekteve të rëndësishme:

- Hartimi i akteve nënligjore që dalin nga Ligji No.08/L-258 për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE). Prej tyre katër (4) akte nenligjore, tashmë janë të hartuara dhe pas diskutimeve releavante brenda ME-së, pritet të dërgohen në procesin e konsultimit paraprak dhe publik, ndërsa tri (3) akte të tjera janë në fazën e hartimit.Në kuadër të mbështetjes teknike me projektin e LUxDeV Janë hartuar edhe tri (3) Udhëzime Administrative për promovimin dhe lehtësimin e integrimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) dhe praktikave të Efiçiencës së Energjisë (EE);
- Janë siguruar pëlqimet dhe lejet e nevojshme, si dhe janë përfunduar procedurat për projektin e ngrohjes qendrore diellore Solar4Kosovo. Është shpallur tenderi për Lot 1 të impiantit të ngrohjes qendrore "Solar4Kosovo SDH II", ndërsa është në fazë parapërgatitore procesi i tenderimit për ekzekutimin e punimeve të projektit "Solar4Kosovo SDH II";
- Në kuadër të promovimit të kapaciteteve të reja gjeneruese përmes ankandeve, është përfunduar faza e parë e kualifikimeve për ankandin e energjisë nga era, ndërsa procesi është në fazën përgatitore për shpalljen e fazës së dytë të propozimeve. Njëkohësisht, për ankandin solar është finalizuar procesi i përzgjedhjes së Inxhinierit të Pavarur. Po ashtu, për përgatitjen e ankandeve të ardhshme për energjinë nga era, Ministria e Ekonomisë (ME), është duke finalizuar procedurat për nënshkrimin e marrëveshjes së grantit që do të mundësojë vendosjen e matësve të erës.

**Objektivi 3: Rritja e Efiçiencës së Energjisë (EE)**

Gjatë periudhës janar– qershor 2025, një sërë aktivitetesh të zhvilluara kanë kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e Efiçiencës së Energjisë (EE), në përputhje me objektivat e përcaktuara në këtë fushë.

Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Është avancuar tutje në parapërgatitje për projektin për rritjen e kapacitetit termit të Kogjenerimit TC "Kosova B" nga 140 MWth në 280 MWth;
- Zbatimi i masave të Efiçiencës së Energjisë (EE) në ndërtesa publike (niveli qendror);
- Zbatimi i masave të Efiçiencës së Energjisë (EE) në ndërtesa publike (në nivel komunal);
- Ka vazhduar instalimi i pajisjeve matëse për konsumatorët e "Termokosit";
- Zbatimi i masave të Efiçiencës së Energjisë (EE) në sektorin rezidencial (shtëpi individuale);
- Hartimi i Projektligjit për Efiçiencë të Energjisë (EE), ende është në proces të diskutimeve relevante brenda institucionti të ME-së dhe posa të përfundoj kjo fazë, pritet me pas të dërgohet tutje për diskutim paraprak dhe publik. Ka dinamikë të shtuar edhe në procesin e hartimit të akteve nënligjore që dalin nga Projektligji i Efiçiencë të Energjisë (EE);

- Është bërë avancim sa i përket miratimit të akteve nënligjore lidhur me Performancën Energjetike të Ndërtesave.

**Objektivi 4: Forcimi i Bashkëpunimit Rajonal dhe Funksionimit të Tregut**

Gjatë periudhës janar–qershor 2025, aktivitetet në kuadër të këtij objektivi kanë qenë të kufizuara, kryesisht për shkak të varësisë së tyre nga procesi i miratimit të Ligjeve për sektorin energjisë (Projektligji për Energjinë, Projektligji për Energjinë Elektrike dhe Projektligji për Rregullatorin e Energjisë), që transopozojnë Pakon e Energjisë së Pastër në zbatimin të obligimeve të Republikës së Kosovës (RK) ndaj Traktatit të Komuinitetit të Energjisë (TKE), si dhe nga mbështetja e programit MCAK.

Evidentohet që Projektligji për Energjinë dhe Projektligji për Energjinë Elektrike kanë përfunduar procesin e konsultimeve paraprake dhe publike, si dhe janë marrë opinionet për vlerësimin e ndikimit financiar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), dhe përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nga Zyra e Kryeministrit, ndërsa Projektligji për Rregullatorin e Energjisë është gati për tu procesuar në konsultim paraprak dhe publik.

Korniza ligjore e energjisë, e cila ndodhet në proces të trajtimit nuk kam mundur të procedohet tutje si rezultat i vonesës se krijimin e institucioneve te reja, pas procesit të fundit zgjedhore apo edhe kufizimet ligjore të Qeverisë së Republikës së Kosovë (QRK) në detyrë.

Ndërsa, vonesa në raport me procesin e implementiumit të metejm të programit MCAK, ka ndodhur si rezultat i nënshkrimi të Urdhërit Ekzekutiv 14169 nga Presidenti i ShBA-së më 20 janar 2025, i cili ka rezultuar në pezullimin e aktiviteteve në kuadër të projektit të MCAK deri të fund të kësaj periudhe raportues.

**Objektivi 5: Mbrojtja dhe Fuqizimi i Konsumatorëve**

Gjatë periudhës janar–qershor 2025, janë realizuar disa nga aktivitetet e planifikuara në kuadër të objektivit pesë (5):

- mbështetje të konsumatorëve të cenueshëm, i cili ka zëvendësuar skemën ekzistuese të mbështetjes për këtë kategori;
- ka vazhduar trajnimi i zyrtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), me qëllim ngritjen e kapaciteteve për monitorimin, vlerësimin, verifikimin dhe raportimin e emetimeve nga impiantet e mëdha me djegie.

# 3 SHTOJCA- MATRICA E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025

***MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË PZSEK-SË PËR PERIUDHËN 2022-2025: OBJEKTIVI STRATEGJIK 1***

**SO1: PËRMIRËSIMI I BESUESHMËRISË SË SISTEMIT**

| Nr. | Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet. | Vlera bazë | Objektivi afatshkurtër 2025 | Objektivi i vitit të fundit 2031 | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|
| **I.** | **OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: PËRMIRËSIMI I BESUESHMËRISË SË SISTEMIT** | | | | |
| 1 | Indikatori: Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjes së sistemit (SAIDI). | SAIDI: 80.83 orë/vit (2021) | SAIDI: 63 orë/vit | SAIDI: 51.84 orë/vit | |
| 2 | Indikatori: Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve të sistemit (SAIFI). | SAIFI: 58.27 (2021) | SAIFI: 49 | SAIFI: 40.86 | |
| **I.1** | **Objektivi specifik: Rritja e fleksibilitetit të sistemit** | | | | |
| | **Indikatori** | **Vlera bazë** | **Objektivi afatshkurtër 2025** | **Objektivi i vitit të fundit 2031** | |
| 1 | Niveli i kapacitetit rregullues fleksibil. | 5 MW (2022) | 5 MW | 170 MW | |

-

| Nr. | Veprimi | Afati i fundit | Buxheti | | | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti | Referenca në dokumente | Progresi në zbatim janar-qershor 2025 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 | Viti 2025 | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.1. 1 | Përgatitja e parafizibilitetit, fizibilitetit dhe projekteve teknike për sistemin e ruajtjes së baterive. | 2025 | € - | $ 1,180,837 .00 | **$ 3,078,637. 00** | $ 242,079.0 0 | Donatorë | MCC, ME KOSTT | Dokumenta cioni teknik i përgatitur. | Strategjia e Energjisë për periudhë n 2022 - 2031 | **Nëntëdhjetë për qind (90%)**<br><br>Është hartuar drafti i dizajnit final për sistemet e ruajtes së energjisë përmes baterive dhe është përgatitur draft dosja e tenderit për sistemet e ruajtjes së energjisë. Po ashtu edhe vlerësimi i aplikimeve për parakualifikimin për tenderin e ndërtimit të sistemeve të ruajtjes së energjisë është draftuar. |
| I.1. 2 | Mbështetje teknike dhe ligjiore për integrimin e baterive - Projekti i MCC | 2025 | € - | $ 1,916,000 .00 | **$ 2,034,667. 00** | $ 2,045,667 .00 | Donatorë t | MCC, ME KOSTT | Dokumenta cioni teknik i përgatitur. | Strategjia e Energjisë për periudhë n 2022- 2031 | **Tetëdhjetë për qind (80%)**<br><br>Janë hartuar termat e referencës dhe draft Marreveshjet me Entitetet Implementuese për hartimin e legjislacionit sekondar që mundëson operimin e sistemeve të ruajtes së energjisë me bateri. |
| I.1. 3 | Master Plani i Zhvillimit të Gazit dhe Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor (VNM). | 2023 | € 750,000. 00 | € 750,000.0 0 | **€ -** | € - | WBIF / IPF9 | ME, MMPHI , MINT | Masterplan i i Gazit dhe Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor (VNM) i Finalizuar. | Strategjia e Energjisë për periudhë n 2022- 2031 | Ka përfunduar në vitin 2023. |
| I.1. 4 | Studimi i fizibilitetit për Gazsjellësin e Interkoneksionit të Maqedonisë Veriore – Kosovë. | 2023 | € 325,000. 00 | € 325,000.0 0 | **€ -** | € - | WBIF/IP F9 | ME, MMPHI , MINT | Studimi i fizibilitetit i finalizuar. | Strategjia e Energjisë për periudhë | Ka përfunduar në vitin 2023. |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | n 2022-2031 | |
| I.1.5 | Studim për identifikimin e potencialit të energjisë gjeotermale në Kosovë. | 2025 | | | | € 750,000.00 | Donatorët | ME | Studimi i fizibilitetit i realizuar. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | |

| **I.2** | **Objektivi specifik: Modernizimi i rrjeteve dhe reduktimi i humbjeve në rrjet** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Indikatori** | **Vlera bazë** | **Objektivi afatshkurtër 2025** | **Objektivi i vitit të fundit 2031** | |
| 1 | Humbjet në shpërndarje | 18.48% [2021] | 13.3 % | 9% | |
| 2 | Sasia e kapacitetit variabil të BRE-ve, që rrjeti është në gjendje të tajtojë/integrojë | 147 MW [2021] | 500 MW | 2000 MW | |

| **Nr.** | **Veprimi** | **Afati i fundit** | **Buxheti** | | | | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe mbështetës** | **Produkti** | **Referenca në dokumente** | **Progresi në zbatim janar-qershor 2025** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Viti** 2022 | **Viti** **2023** | **Viti** **2024** | **Viti** 2025 | | | | | |
| I.2.1 | Zhvillimi i sistemit (SCADA & Telekomunikacion). | Vjetore | € - | € 5,684,923.33 | **€ 4,063,814.93** | € 1,863,702.50 | KOSTT | KOSTT | Kërkesat e ENTSO-E janë plotësuar. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | **Dhjetë për qind (10%)** Ky projekt i takon grupit të projekteve që do të realizohen me bankën Gjermane KfW faza e VII . Është nënshkruar kontrata për shërbime konsulente më 26 nëntor 2024 për përgatitjen e specifikimit teknik dhe tender dosjen. Është përgatitur dokumenti final Inception Report dhe draft dokumenti Upcoming open Calls. |
| I.2.2 | Përforcimi dhe rehabilitimi i rrjetit ekzistues të energjisë (OST) | Vjetore | € 2,400,000.00 | € 2,260,000.00 | **€ 1,063,542.37** | € 1,354,203.39 | KOSTT | KOSTT | Rritja e besueshmërisë dhe sigurisë së rrjetit | Strategjia e Energjisë për periudhë | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | n 2022-2031 | **Dhjetë për qind (10%)**<br><br>Ky projekt i takon grupit të projekteve që do të realizohen me bankën Gjermane KfW faza e VII. Është nënshkruar kontrata për shërbime konsulente më 26 nëntor 2024 për përgatitjen e specifikimit teknik dhe tender dosjen. Është përgatitur dokumenti final Inception Report dhe draft dokumenti Upcoming open Calls. |
| I.2.3 | Ndërtimi i kapaciteteve të reja të transmetimit dhe kapaciteteve transformuese - Reaktori shunt-variabël (100 MWAr). | 2025 | € - | € 1,000,000.00 | € - | € 3,449,152.54 | KOSTT | KOSTT | Rritja e besueshmërisë dhe sigurisë së rrjetit. Plotësimi i kërkesave të Kodit të Rrjetit. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | |
| I.2.4 | Mbështetja e ngarkesës/ Nyjet e reja 110/10 (20) kV (OST & OSSh) (SS Katrioti - Ferizaj 3 dhe TS Malisheva"<br>(SS Katrioti - Ferizaj 3 and TS Malisheva. | Vjetore | € 3,000,000.00 | € 5,061,277.00 | **€ 10,094,931.52** | € - | KOSTT | KOSTT | Reduktimi i humbjeve të energjisë dhe fuqisë së pashërbyer. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | **Tetëdhjetë e pesë për qind (85%)**<br><br>1. Projekti "Ndërtimi I NS 110/35/10(20) kV Ferizaji 3" ka përfunduar.<br><br>2.Sipas ligjeve në fuqi është përgaditur Dizajni për nënstacionin e NS Malisheva , nga kompania dizajnuese, janë marrë kushtet ndërtimore, pritet edhe leja e ndërtimit nga MMPHI-ja. Është përgatitur specifikimi teknik dhe është hapë periudha tenderuese. |
| I.2.5 | Projektet e Tensionit të Mesëm 35/10(20) kV | Vjetore | € 9,247,735.33 | € 13,216,444.00 | **€ 8,800,613.00** | € 7,232,203.00 | KEDS | KEDS | Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatorit të Sistemit | **Gjashtëdhjetë e dy për qind (62%)**<br>4,507,520.08 €<br><br>Projektet e planifikuara për investim në nivelin e tensionit të mesëm janë dizajnuar për të mundësuar furnizim të sigurt dhe të pandërprerë me energji për konsumatorët. Në vitin 2025, janë implementuar projekte investive në rrjetin e tensionit të mesëm pothuajse në të gjithë territorin e vendit, me fokus të veçantë në |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | të Shpërndarjes për periudhën 2023-2027 | rajonet: Prishtinë, Drenas, Fushë - Kosovë, Podujevë, Gjakovë, Malishevë, Rahovec, Pejë, Deçan, Ferizaj, Prizren, Suharekë, Viti, Vushtrri. Deri më tani, është arritur një progres i konsiderueshëm në realizimin e këtyre projekteve. Përfitimet nga këto projekte janë:<br>• Sigurimi dhe rritja e kualitetit të furnizimit me energji elektrike<br>• Eliminimi i fyteve të ngushta;<br>• Zvogëlimi i humbjeve teknike;<br>• Përmirësimi i rënieve të tensionit deri te konsumatori fundor;<br>• Shtimi i kapaciteteve bartëse (dalje të reja) në raport me rritjen e ngarkesës;<br>• Rehabilitimi dhe modernizimi i linjave dhe nënstacioneve/stabilimenteve;<br>• Rehabilitimi topologjik i linjave për shkak të vjetërsisë dhe rrezikshmërisë;<br>• Përgatitja e linjave për kalim në nivelin 20 [kV]. |
| I.2.6 | Projektet e Tensionit të Vogël 0.4 kV | | Vjetore | € 6,086,381.41 | € 7,025,149.00 | **€ 13,795,229.00** | € 9,677,563.00 | KEDS | KEDS | Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhë | **Tridhjetë e pesë për qind (35%)**<br><br>3,404,583.12€<br><br>Investimet në rrjetin e tensionit të ulët janë orientuar në përforcimin e rrjetit ekzistues dhe zgjerimin e rrjetit. Projektet e tipit "Lidhjet e reja", të cilat implementohen nga OSSh, gjithashtu klasifikohen si pjesë e zgjerimit të rrjetit. Deri më tani, është shënuar një progres i dukshëm në realizimin e projekteve, me përfundimin e një numri të konsiderueshëm të tyre. Në vitin 2025, janë implementuar projekte investive në rrjetin e tensionit të mesëm pothuajse në të |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | n 2023-2027 | gjithë territorin e vendit, me fokus të veçantë në rajonet: Prishtinë, Drenas, Obiliq, Podujevë, Gjakovë, Malishevë, Rahovec, Pejë, Deçan, Klinë, Ferizaj, Lipjan, Shtime, Prizren, Suharekë, Mitrovica Veriore, Vushtrri, Skenderaj dhe Viti. Investimet e bëra në projektet e tensionit të ulët përfshijnë:<br>• Transformatorë të rinj në zonat që kanë nevojë për investime;<br>• Zëvendësimi i transformatorëve ekzistues me ata të ri; për rritjen e kapacitetit;<br>• Rehabilitimi i rrjetit të tensionit të ulët;<br>• Përforcimi i rrjetit të tensionit të mesëm brenda fushëveprimit të projekteve të TU, në përputhje me planet e ardhshme të daljeve te TM;<br>• Zgjerimi i rrjetit të TM për kyçjen e transformatorëve të ri. |
| "I.2.7 | Rrjeti i zgjuar (Smart Grid) | Vjetore | € 14,513.93 | € 2,413,843.29 | **€ 3,444,527.64** | € 1,765,071.00 | KEDS | KEDS | Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2023-2027 | **Njëzet e katër për qind (24%)** 432,114.23€<br><br>Gjatë vitit 2025 janë realizuar investime të rëndësishme në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e efikasitetit operacional dhe besueshmërisë së furnizimit për konsumatorët. Në fokus të këtyre investimeve ka qenë modernizimi teknologjik i rrjetit përmes implementimit të pajisjeve të mençura (smart devices) në nyjet kryesore të shpërndarjes, të cilat mundësojnë mbikëqyrje dhe kontroll në kohë reale të parametrave të rrjetit. Gjithashtu, është zgjeruar dhe instaluar sistemi SCADA në një numër të konsiderueshëm të |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | stabilimenteve, çka ka rritur kapacitetin e monitorimit, analizimit dhe ndërhyrjes së shpejtë në raste avarish.<br><br>Ndërrimi dhe modernizimi i skemave mbrojtëse përmes zëvendësimit të mbrojtjeve ekzistuese me mbrojtje rele të avancuara në nënstacione ka kontribuar në përmirësimin e sigurisë dhe selektivitetit të ndërhyrjeve mbrojtëse. Një tjetër hap strategjik ka qenë fillimi dhe faza e projektimit të një prej projekteve më të rëndësishme të transformimit digjital të rrjetit: implementimi i sistemit GIS (Geographic Information System), i cili do të mundësojë menaxhim më të saktë, planifikim të optimizuar dhe ndërhyrje më efikase në rrjet përmes vizualizimit të detajuar dhe të sinkronizuar të të gjitha aseteve.<br><br>Të gjitha këto investime të ndërmarra deri më tani kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e monitorimit të rrjetit, identifikimin dhe lokalizimin më të shpejtë të defekteve, si dhe në rritjen e performancës së përgjithshme të sistemit shpërndarës. |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.2.8 | Instalimi i njehësorëve. | Vjetore | € 1,612,032.60 | € 4,000,015.00 | **€ 2,494,035.00** | € 2,111,940.00 | KEDS | KEDS | Reduktimi i humbjeve komerciale për periudhën 2022-2025 parashikohet të instalohen rreth 121,782 njehsorë të rinjë - lidhjet e reja, ndërsa parashikohet të ndërrohen rreth 86,578 njehsorë. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2023-2027 | **Zero për qind (0%)** |
| I.2.9 | Investimet kapitale në teknologjinë informative. | Vjetore | € 896,096.30 | € 1,544,650.00 | **€ 2,147,700.00** | € 1,331,800.00 | KEDS | KEDS | Funksionimi i sigurtë i OSSH-së. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 Plani Zhvillimor dhe Investiv i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2023-2027 | **Pesëdhjetë e dy për qind ( 52%)**<br><br>688,814.48€<br>Projektet e teknologjisë informatike janë investime me rëndësi të lartë për OSSh-në,gjatë vitit 2025, janë bërë përparime të rëndësishme në zhvillimin dhe përmirësimin e sistemeve IT-së. |
| **I.3** | **Objektivi specifik: Rehabilitimi i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit të energjisë elektrike** | | | | | | | | | | |

| | Indikatori | Vlera bazë | Objektivi afatshkurtër 2025 | Objektivi i vitit të fundit 2031 | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Numri i njësive të rinovuara të linjitit. | 0 [2021] | 2 | 3 ose 4 | |
| 2 | Numri i njësive të mbyllura të linjitit. | 0 [2021] | 0 | 1 ose 2 | |

| Nr. | Veprimi | Afati i fundit | Buxheti | | | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti | Referenca në dokumente | Progresi në zbatim janar-qershor 2025 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Viti 2022 | Viti **2023** | Viti **2024** | Viti 2025 | | | | | |
| I.3.1 | Rehabilitimi i njësisë "Kosova B1" | 2024 | € - | € 7,500,000.00 | **€ 88,000,000.00** | € - | KEK: € 49.5 milion Granti nga BE: € 38.5 milion (Elektrofiltrat & De-Nox). | KEK, ME, ZRrE | Reduktimi i emetimit të pluhurit, NOx dhe $SO_2$ Pluhuri: 20 mg/ Nm³, NOx: 200 mg/ Nm³, $SO_2$: 600 mg/ Nm | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 Strategjia Zhvillimore e KEK-ut për periudhën 2021-2025 | **Zero për qind (0%)**<br>Projekti i elektrofiltrave dhe De NOX planifikohet të realizohet në njësinë B1 në vitin 2026 (prill-tetot). |
| I.3.2 | Rehabilitimi i njësisë "Kosova B2" | 2025 | € - | € 7,500,000.00 | € - | € 88,000,000.00 | KEK - €49.5 milion EU Grant -€ 38.5 milion (Electrofilter & De-Nox) | KEK, ME, ZRrE | | | **Zero për qind (0%)**<br>Projekti i elektrofiltrave dhe De NOX planifikohet të realizohet në njësinë B2 në vitin 2027 (prill-tetor). |
| I.3.3 | Rehabilitimi i një njësie të "Kosova A" | 2024 | - | € 15,000,000.00 | **€ 105,000,000.00** | € - | KEK | KEK, ME, ZRrE | Rritja e kapacitetit nga 130 MW në 180 MW. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | **Zero për qind (0%)**<br>Shpallja e aktivitetit Faza e I/parakualifikimi është bërë më datë 23 janar 2025. Disa herë është shtyrë afati i dorëzimit të dokumenteve me kërkesë të |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | kompanive të interesura. Hapja zyrtare e aplikimit të Operatorëve Ekonomikë (OE), është bërë më datë 17 korrik 2025, pas hedhjes poshtë të ankesës së operatorit nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OShP). |
| I.3.4 | Makineri, shirita transportues, shpronësime dhe investime të tjera në shpronësimin e minierave. | 2024 | € 3,800,000.00 | € 48,200,000.00 | **€ 28,340,000.00** | € 28,340,000.00 | KEK | KEK, ME, ZRrE | Investimet në minierë | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | **Nëntëdhjetë për qind (90%)**<br><br>Shpronësim në hapësirën 100 ha është finalizuar, kanë mbetë vetëm disa prona të cilat do të shponësohen sipas ligjit për shpronësim. Pjesa më e madhe e shpronësimit është realizuar në vitin 2024, pjesa e mbetur në periudhën janar - qershor 2025. |
| **I.4** | **Objektivi specifik: Garantimi i sigurisë kibernetike të sektorit të energjisë** | | | | | | | | | | |
| | **Indikatori** | **Vlera bazë** | | | **Objektivi afatshkurtër 2025** | | **Objektivi i vitit të fundit 2031** | | | | |
| 1 | Aftësitë e reagimit kibernetik. | Nuk ekziston | | | Ekzistojnë | | Ekzistojnë | | | | |
| **Nr.** | **Veprimi** | **Afati i fundit** | **Buxheti** | | | | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe mbështetës** | **Produkti** | **Referenca në dokumente** | **Progresi në zbatim janar-qershor 2025** |
| | | | **Viti** 2022 | **Viti 2023** | **Viti 2024** | **Viti** 2025 | | | | | |
| I.4.1 | Miratimi i ligjit për sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve informative. | 2022 | € 120,000.00 | € - | **€** - | € - | Buxheti i Kosovës (BK). | MPB, ME, | Ligji i adoptuar | Raporti i Performancës Vjetore | **Njëqind për qind (100%)**<br><br>Ligji për Sigurinë Kibernetike ka përfunduar në vitin 2023. https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=70933 |
| I.4.2 | Miratimi i akteve nënligjore që rrjedhin nga ligji për sigurinë e rrjeteve dhe | 2023 | € - | € 100,000.00 | **€** - | € - | Buxheti i Kosovës (BK). | MPB, ME,ZRrE, KOSTT | Legjislacioni sekondar i aprovuar. | Ligji për sigurinë e rrjeteve dhe sistemev | **Shtatëdhjetë për qind (70%)**<br><br>Aktet nënligjore që derivojnë nga Ligji Nr. 08/l-173 për Sigurinë Kibernetike/ data e publikimit: Më |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | sistemeve informative. | | | | | | | | | e informative. | 27 shkurt 2023. Aktet nënligjore të miratuara:<br><br>1. Rregullore (QRK) - Nr. 22/2023 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Qendrës Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike/ data e publikimit: Më 5 janar 2024.<br>2. Rregullore (MPB) Nr. 02/2025 për Përcaktimin e Procedurës së Punës dhe Funksionimit të Këshillit Shtetëror për Siguri Kibernetke/data e publikimit: Më 4 prill 2025.<br>3. Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 11/2024 për Kompetencat, Mandatin dhe Përbërjen e Komisionit të Ankesave Kundër Vendimeve të Agjencisë për Siguri Kibernetike/data e publikimit:Më 26 dhjetor 2024.<br>4. Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 08/2024 për Masat dhe Procedurat që Kufizojnë ose Pezullojnë Përkohësisht Përdorimin ose Qasjen në Sistemet e Rrjetit apo Informacionit në Rast të Incidentit Kibernetik/data e publikimit: Më 9 tetor 2024.<br>5. Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 05/2024 për Regjistrin e Rreziqeve dhe Kërcënimeve të Sigurisë Kibernetike/data e publikimit: Më 3 shtator 2024.<br>6. Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr.03/2024 për Peocedurën e Njoftimit dhe Përmbajtjen e Raportit të Incidentit Kibernetik/data e publikimit:Më 27 gusht 2024.<br>7. Udhëzimi Administrativ (MPB) 04/2024 për Regjistrin e Incidenteve Kibernetike/data e publikimit: Më 27 gusht 2024. |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | 8. Rregullore (ZKM) Nr. 05/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Siguri Kibernetike/data e publikimit:Më 7 mars 2024. |
| I.4.3 | Themelimi i Ekipit Sektorial të Energjisë për Reagim ndaj Emergjencave Kompjuterike (eCERT) në Kosovë. | 2025 | € - | € 252,250.00 | **€ 300,000.00** | € 50,000.00 | Buxheti i Kosovës (BK), donatorët. | ME, CERTi nacional, MPB, ZRrE, KOSTT, KEK, KEDS | Ekipi Sektorial i Energjisë për Reagim Emergjent (eCERT) në Kosovë i themeluar. | Strategjia e Energjisë për periudhën 2022-2031 | **Pesëdhjetë për qind (50%)**<br><br>Termat e Referencës për formimin e eCERT të përfunduara. |

## *MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË PZSEK PËR PERIUDHËN 2022-2025: OBJEKTIVI STRATEGJIK 2*

### SO2: DEKARBONIZIMI DHE PROMOVIMI I ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME

